

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Abdullah Ahmeti, kryetar, Dr.sc.Driton Muharremi, Mejreme Memaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit K.K. për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit K.K. av. H.N. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.128/16 datë 14.06.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 29.01.2019 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit K.K., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.128/16 datë 14.06.2018, **vërtetohet.**

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj-departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.128/16 datë 14.06.2018, të akuzuarin K.K. e ka shpallur fajtorë për shkak të veprës penale, Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPRK-së, për çka e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 11.03.2010 deri më 31.01.2011. Konfrom nenit 60 par.1 të KPK-së i shqiptohet dënimi plotësues- marrja e sendit me të cilin është kryer vepra penale siç janë : një thikë kuzhine me teh 21.5 cm dhe një brisk me teh 6.5 cm me gjatësi 14.5 cm. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 50 euro, në emër të paushallit gjyqësor ti paguaj shumën prej 50 euro, si dhe të paguaj shumën prej 50 euro në Fondin për kompensimin e viktimave të dhunës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin r përmbarrimit të dhunshëm. I dëmtuari I.I. për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

-Mbrojtësi i të akuzuarit K.K. av. H.N., për shkak të vendimit lidhur me dënimin e shqiptuar dhe mos aplikimin e drejtë të dispozitave të drejtës materiale, me propozim që Gjykata

Apelit ta aprovoj ankesën, aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshoj duke i zvogëluar dënimin të akuzuarit.

Gjykata e Apelit e caktoj dhe mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, në të cilën prezent ishte vetëm i akuzuari K.K., kurse nuk prezantuan Prokurori i Apelit, mbrojtësi i të akuzuarit H.N. dhe pala e dëmtuar I.I. edhe pse te ftuar me rregull. I akuzuari mbeti pranë ankesës së paraqitur me shkrim.

- Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.570/2018 të dt. 27.12.2018 ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit K.K. av. H.N., të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa është e pa bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. As gjendja faktike nuk qe objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase nuk është kontestuar me ankesë, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në frymë të pretendimeve ankimore.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit K.K. av. H.N. lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesa është e pa bazuar. Në ankesën e mbrojtësit nuk ceket ndonjë rrethanë e re e që do të ndikonte në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit. Mbrojtja në ankesë thekson se i mbrojturi i tij pretendon se e ka kryer këtë vepër penale tërësisht në vetëmbrojtje por meqë procedura gjyqësore është zvarrit nga janari i vitit 2010 e me qëllim të përmbjlljes së këtij kapitulli të stërzgatur dhe racionalizimit të procedurës gjyqësore e ka pranuar fajësinë duke mendu se Gjykata do të kenë si rrethanë posaçërisht lehtësuese këtë rrethanë me rastin e matjes së dënimit. Gjykata nuk e ka aplikuar fare institutin e zbutjes së dënimit por më ka dënuar me burg 1 vit e 6 muaj për një vepër që e kam kryer në vetëmbrojtje, jam penduar thellë edhe se në vetëmbrojtje por normalisht se kam faj dhe si të tillë edhe e kam pranuar fajin për këtë vepër penale. Në rastin kur Gjykata do ta aplikonte institutin e zbutjes së dënimit për çka thirret gjykata, e faktin se ka vlerësuar pranimin e fajësisë si rrethanë posaçërisht lehtësuese por se zbutë farë dënimin së paku në minimumin e lejuar 1 vjet, çka konsideroj se dënimi prej 1 vit e 6 muaj është shumë i lartë sidomos nga koha e kaluar se unë kam qenë gjatë në paraburgim dhe pas kësaj kohe edhe me një dënim më të ulët do të arrihet efekti korrektues dhe përmirësuese se unë tanimë edhe kam kërkuar falje palës së dëmtuar, jam mbajtës i familjes i gjendjes së dobët ekonomike, i kam premtuar Gjykatës se nuk do të kryej në të ardhmen kurrë vepër të tillë penale po te ngjashme me pendim të thellë.

Mirëpo, Gjykata e Apelit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat drejtë i ka vlerësuar Gjykata e shkallës së parë dhe atë si rrethanë veçanërisht lehtësuese për të akuzuarin pati parasysh faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, se vepra penale ka mbetur në tentativë, mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, i cili ka pasur sjellje korrekte, ka shprehur keqardhje dhe është pënduar thellë për veprën pe kryer penale, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra te tilla ose të ngjashme, është i moshës relativisht të re, është i vetmi mbajtës i familjes, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor, gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimin e paraparë ligjor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.601/18, më 29.01.2019

Procesmbajtëse,
Syzana Goxhuli

Kryetar i kolegjit- gjyqtari
1. Abdullah Ahmeti_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi_____

3. Mejreme Memaj _____